

VENDIM
Nr. 66, datë 13.2.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 789, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE
PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të kreut II, të vendimit nr. 789, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Nën-pika 1.2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1.2. Ata profesionistë, të cilët mbushin moshën e daljes në pension brenda periudhës së programit të certifikimit dhe nuk kërkojnë rinovimin e lejes së ushtrimit të profesionit nga urdhri profesionist përkatës, përjashtohen nga detyrimet e programit të certifikimit.”.

2. Nën-pikat 1.4 e 3.5 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe